



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3306/8 prot.

Datë 23.12.2025

V E N D I M
Nr. 1895/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.12.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik Besim Ksamberi, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-62704-09-25-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi - Marrëveshje Kuadër me afat 12 mujor - Me një operator ekonomik fitues ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.”, me fond limit 16,872,275 (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa T.V.SH ose 174,138.46 (njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e tridhjetë e tetë pikë dyzetë e gjashtë) Euro, zhvilluar më datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “MURATI D” SHPK dhe “EUROMEGA 2010” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-62704-09-25-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi - Marrëveshje Kuadër me afat 12 mujor - Me një operator ekonomik fitues ku të gjitha kushtet

janë të përcaktuara.”, me fond limit 16,872,275 (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa T.V.SH ose 174,138.46 (njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e tridhjetë e tetë pikë dyzetë e gjashtë) Euro, zhvilluar më datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë

Ankimues: Operatori ekonomik Besim Kamberi me Nipt L42103023G dhe adresë: Rruga e Qelqit , Zona Kadastrale Nr 3866 Nr Pasurie 310/20 - Kashar, Tiranë.

Operatori ekonomik “ANBIM” SHPK me Nipt. L81618008J dhe adresë: Autostrada TR-DR Km1 Zona kadastrale 2679 Numri pasurise 40/55 Tiranë..

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë
Rr. “Barrikadave”, Tiranë

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “MURATI D” SHPK me Nipt. K42003004T dhe adresë Rruga Kavajes, Ish- Kombinati Ushqimor, Godine 1-kateshe, Tiranë

Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK, me NUIS K91624505A, me adresë: Fshati Ahemtaq, pranë firmës Ital Kon, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi “ANBIM” SHPK nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik..

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.09.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit ““Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-62704-09-25-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi - Marrëveshje Kuadër me afat 12 mujor - Me një operator ekonomik fitues ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.”, me fond limit 16,872,275 (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa T.V.SH ose 174,138.46 (njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e tridhjetë e tetë pikë dyzetë e gjashtë) Euro, zhvilluar më datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 27.10.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 06.11.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “AMBIM” SHPK	12,838,980 lekë skualifikuar
2. BESIM KAMBERI	12,758,550 lekë skualifikuar

3. "EURO MEGA 2010" SHPK	11,930,100 lekë kualifikuar
4. "MURATI D" SHPK	10,257,975 lekë kualifikuar
5. "Pastrime Silvio" SHPK	14,513,625 lekë skualifikuar

II.4. Në datën 06.11.2025 operatori ekonomik Besim Kamberi është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

- *2.3.5 Raport analizat e paraqitura në SPE për produktet detergjent rrobash;solucion larës enësh; solucion, zbardhues, dizifektues;ilaç xhamash;solucion pllakash;sapun rrobash;sapun tualeti;solucion për pastrimin e sobave dhe solucion parketi nuk përmbajnë të gjithë treguesit e kërkuar sipas specifikimeve teknike. Në asnjë nga raport analizat nuk është përcaktuar emri markës tregtare të mostrave të analizuara.*

2.3.6 Mostrat e paraqitura nuk përputhen me raport analizat e depozituara në SPE.

II.5. Në datën 07.11.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik "Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak" për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.6. Në datën 17.11.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa menumër elektronik A/2025/6088, datë 17.11.2025 dhe me Nr. 3306/2025 Prot., datë 18.11.2025 e operatorit ekonomik Besim Kamberi, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike si dhe me kualifikimin e ofertave ekonomike nga opertorwt ekonomikw "MURATI D" SHPK dhe "EUROMEGA" SHPK

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3306/1 prot., datë 19.11.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik Besim Kamberi kundërshton me anë të ankesës me nr. 3306 prot, datë 18.11.2025.

II.8. Në datën 17.04.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është depozituar ankesa me ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/6089, datë 17.11.2025 dhe me Nr. 3307/2025 Prot., datë 18.11.2025 e operatorit ekonomik "ANBIM" SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekomomikë "MURATI D" SHPK dhe "EUROMEGA 2010" SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar

II.9. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3307/1 prot., datë 19.11.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “ANBIM” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 3307 prot, datë 18.11.2025.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur ankesës së mësipërme konstatohet, se formulari i ankesës së dorëzuar është me të meta, pasi mungon dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

II.10. Nëpërmjet shkresës datë 26.11.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 3306/2 prot., datë 26.11.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor ekstrakti i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës mos pranimin e saj.

II.11 Nëpërmjet shkresës me nr. 1791/7 prot., datë 26.11.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 3306/3 prot., datë 27.11.2025 me objekt “Kthim-përgjigje”, është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës mos pranimin e saj.

II.12. Nëpërmjet shkresës me nr. 1732/4 prot., datë 25.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3307/2 prot., datë 26.11.2025 me objekt “informacion mbi ankesën e OE “ANBIM” SHPK për procedurën e prokurimit “Blerje materiale pastrimi”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe vendimin e KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “ANBIM” SHPK nga ku rezulton se autoriteti kontraktor nuk e ka marrë në shqyrtim ankesën e këtij të fundit.

II.13. Me qëllim verifikimin e mëtejshëm në lidhje me pagesën e tarifës financiare, KPP iu drejtua me shkresën nr. 3307/3 prot., datë 15.12.2025 Drejtorisë së Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës pranë KPP-së për informacion mbi pagesën e tarifës financiare të kryer nga operatori ekonomik “ANBIM” SHPK për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.14. Me shkresën nr. 3307/4 prot., datë 16.12.2025, Drejtoria e Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës informon se: Në përgjigje të shkresës nr.3307/3 prot, datë 15.12.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion”, ju bëjmë me dije se për ankesën me nr.3307/2025 prot., datë 18.11.2025, me numër ankimi elektronik A/2025/6089, operatori ekonomik “ANBIM” SHPK nuk ka paraqitur dokumenti bankar në seksionin mandat pagese. Në vijim të shkresës tuaj, janë kryer verifikime me raportin e datës 12.12.2025 të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e muajit nëntor –dhjetor ku rezulton se operatori ekonomik “ANBIM” SHPK nuk ka kryer pagesë për ankesën e sipërcituar në favor të Komisionit të Prokurimit Publik”.

II.15. Me shkresën nr. 3306/4 prot., datë 17.12.2025, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit kontraktor me kërkese për dorëzimin e mostrave për procedurën e prokurimit të sipërmendur si dhe dokumentacionin shoqërues.

II.16. Me procesverbalin e datës 19.12.2025 protokolluar me tonën nr. 3306/5, prot., datë 19.12.2025, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin i Prokurimit Publi , mostrat për procedurën e prokurimit të sipërmendur dhe dokumentacionin shoqërues.

II.17. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik në datë 17.04.2025, me nr. Ankimi elektronik A/2025/6089, datë 17.11.2025 dhe me Nr. 3307/2025 Prot., datë 18.11.2025 e operatorit ekonomik “ANBIM” SHPK për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “MURATI D” SHPK dhe “EUROMEGA 2010” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

*“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.
2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.*

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.1.2. Nëpërmjet shkresës me nr. 1732/4 prot., datë 25.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3307/2 prot., datë 26.11.2025 me objekt “informacion mbi ankesën e OE “ANBIM” SHPK për procedurën e prokurimit “Blerje materiale pastrimi”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe vendimin e KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “ANBIM” SHPK nga ku rezulton se autoriteti kontraktor nuk e ka marrë në shqyrtim ankesën e këtij të fundit..

III.1.3. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

III.1.4. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

III.1.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP përmes shkresës nr. shkresës nr. 1732/4 prot., datë 25.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3307/2 prot., datë

26.11.2025 rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, duke kërkuar operatorit ekonomik ankimues “ANBIM” SHPK, ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit ka pranuar ankesën. Ndërkohë nga verifikimi i fashikullit administrativ Komisioni konstaton se operatori ekonomik ankimues nuk i ka bashkëlidhur ankesës dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës së ankesës. Referuar arsyetimit, në kushtet kur operatori ekonomik ankimues nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ankesa operatorit ekonomik “ANBIM” SHPK nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj, bazuar “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kjo ankesë duhet refuzuar.

III.2. Lidhur me pretenimin e operatorit ekonomik Besim Kamberi mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyetimin se “*Raport analizat e paraqitura në SPE për produktet detergjent rrobash; solucion larës enësh; solucion, zbardhues, dizifektues; ilaç xhamash; solucion pllakash; sapun rrobash; sapun tualeti; solucion për pastrim sobave dhe solucion parketi nuk përmbajnë të gjithë treguesit e kërkuar sipas specifikimeve teknike. Në asnjë nga raport analizat nuk është përcaktuar emri i markës tregtare të mostrave të analizuara. - 2.3.6 Mostrat e paraqitura nuk përputhen me raport analizat e depozituara në SPE.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3. “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.5 Vetëm për produktet:

Nr	Emërtimi i produktit
1	Detergjent rrobash
2	Solucion larës enësh.

3	<i>Solucion, zbardhues, dizifektues</i>
4	<i>Ilaç xhamash</i>
5	<i>Solucion pllakash</i>
6	<i>Sapun rrobash</i>
7	<i>Sapun tualeti</i>
8	<i>Solucion për pastrimin e sobave</i>
9	<i>Solucion parketi</i>

OE duhet të paraqesë **Raport Analizë** nga ISHTI (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), ose laborator tjetër ekuivalent.

Raport Analiza duhet të përmbajë të gjithë treguesit dhe parametrat e kërkuar për secilin produkt në specifikimet teknike.

2.3.6 Ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Një mostër për secilin artikull të kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
- Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara dhe raport analizat të depozituara në SPE.
- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë D. P. Ç. K - ve, Rruga e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tiranë.
- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.

Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.

III.2.2.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik Besim Kamberi, për përmbushjen e kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentat si më poshtë:

- 3 Raport_Analizë nga ISHTI

III.2.3. Me procesverbalin e datës 19.12.2025 protokolluar me tonën nr. 3306/5, prot., datë 19.12.2025, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin i Prokurimit Publi , mostrat për procedurën e prokurimit të sipërmendur dhe dokumentacionin shoqërues ndër të cilat janë dhe mostrat e dorëzuara nga subjekti Besim Kamberi

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.2.6. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

- 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
 - a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
 - b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
 - c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]

- 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.2.7. Në nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse 16 ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi

ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet 34 evropiane.”

III.2.8. Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.2.9. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në

rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike..”.

III.2.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë 36 pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.11. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, në rastin

konkret raport analizat, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Autoriteti kontraktor me qëllimin e vlerësimit të specifikimeve teknike të mallit objekt - prokurimi ka kërkuar në DST që operatorët ekonomikë të paraqesë **Raport Analizë** nga ISHTI (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), ose laborator tjetër ekuivalent. Raport Analiza duhet të përmbajë të gjithë treguesit dhe parametrat e kërkuar për secilin produkt në specifikimet teknike..

Operatorët ekonomikë ofertues në përmbushje të specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet dokumentacionit provues (në rastin konkret raport analiza për produktet që do të ofertojnë) duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit të paraqitur me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që vlerësimi i parametrevë të produkteve të ofertuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të kryhet në mënyrë të saktë në përputhje me parametrat e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht të realizohet me sukses kontrata objekt prokurimi.

III.2.12. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.2.13. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet se në kriterin kualifikues të pikës 2.3. pika 8 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor sipas parashikimeve ligjore të sipërpërmendura, ka përcaktuar që ofertuesit duhet të paraqesin Operatori ofertues duhet të paraqesë të paraqesë **Raport Analizë** nga ISHTI (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), ose laborator tjetër ekuivalent. Raport Analiza duhet të përmbajë të gjithë treguesit

dhe parametrat e kërkuar për secilin produkt në specifikimet teknike.. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Besim Kamberi rezulton, se ky i fundit ka paraqitur raport testimet datë 15.10.2025 të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për produktet si më poshtë:

- Detergjent rrobash
- Solucion larës enësh
- Solucion, zbardhues, dizifektues (ACE)
- Ilaç xhamash
- Solucion pllakash
- Sapun rrobash
- Sapun tualeti
- Solucion për pastrimin e sobave
- Solucion parketi

.Referuar procesverbalit të datës 27.10.2025 për marrjen në dorëzim të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik Besim Kamberi, mostra të cilat janë dorëzuar dhe pranë KPP më datë 19.12.2025 në bazë të kërkesës që KPP i ka bërë autoritetit kontraktor konstatohet se janë paraqitur ndër të tjera dhe mostrat për të cilat është kërkuar fletë analiza dhe konkretisht: Detergjent rrobash i i markës ABC; Solucion larës enësh i markës Punus; Solucion, zbardhues, dizifektues i markës ACE; Ilaç xhamash i markës Punus; Solucion pllakash i markës Punus; Sapun rrobash i markës Sping; Sapun tualeti i markës Spring; Solucion për pastrimin e sobave i markës Punus dhe Solucion parketi i markës Punus.

KPP nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm konstaton se, për artikujt e mësipërm janë lëshuar fletë analiza nga Inspektorati Shtetëror Teknik sipas kërkesës 2.3.5 të DST por ajo që konstatohet është se në këto raport testimesh nuk evidentohet marka e artikullit për të cilin është lëshuar ky raport testimi.

Në këto kushte kriteri i paraqitjes së mostrave nuk mund të merret në konsideratë përsa kohë nuk bëhet lidhja e saj (mostrës) me produktin për të cilin është kryer raport testimi. Mos evidentimi i markës së testuar krijon konfuzion në momentin e paraqitjes së mostrave të cilat duhet të jenë në përpuethshmëri të plotë me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara dhe raport analizat të depozituara në SPE.

KPP sqaron, se subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe

specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër pretendimet i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik Besim Kambri për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “MURATI D” SHPK dhe “EUROMEGA 2010” SHPK, në këtë procedurë prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se,

III.3.1. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.3.2. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.3.3. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislati janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një

autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimimi *locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t'u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar.

III.3.5. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin, vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ANBIM” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-62704-09-

25-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi - Marrëveshje Kuadër me afat 12 mujor - Me një operator ekonomik fitues ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.”, me fond limit 16,872,275 (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa T.V.SH ose 174,138.46 (njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e tridhjetë e tetë pikë dyzetë e gjashtë) Euro, zhvilluar më datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë

2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik Besim Kamberi për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-62704-09-25-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi - Marrëveshje Kuadër me afat 12 mujor - Me një operator ekonomik fitues ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.”, me fond limit 16,872,275 (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa T.V.SH ose 174,138.46 (njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e tridhjetë e tetë pikë dyzetë e gjashtë) Euro, zhvilluar më datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik Besim Kamberi.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Florent Zguro

